



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË  
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. I dëmtuari akuzues **Fredi Konkoneshi**, më datë **04.04.2024** ka paraqitur pranë kësaj Gjykate kërkesën për gjykimin e çështjes penale me objekt: “Fillimin e procedimit penal ndaj Partisë Demokratike, për z. **Myslim Murrizi**, z. **Ervin Salianji**, deklarimin fajtor për kryerjen e veprës penale të “*Shpifjes*”, parashikuar nga neni 120 i K.Penal”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Rudina Palloj, bazuar në nenet 112, 328 pika 1, shkronja ç) dhe f) dhe 59 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në nenet 66, shkronja dh) dhe 120 të Kodit Penal, me vendimin **nr.50**, datë **10.09.2024** vendosi:

1. Pushimin e çështjes penale me nr. 70, datë regjistrimi 04.04.2024, me palë:  
I dëmtuar akuzues: Shtetasi **Fredi Kokoneshi**;  
Të akuzuar: Shtetasi **Myslym Murizi** dhe shtetasi **Ervin Salianji**;  
Akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Shpifja*”, parashikuar nga neni **120** i Kodit Penal, *pasi ndjekja penale është ushtruar në tejkalim të afatit të parashkrimit, sipas parashikimeve të nenit 66, shkronja dh) të Kodit Penal*, dhe për këtë shkak, në referim të nenit 328, pika 1, shkronja f) të K.Pr.Penale, nuk mund të vazhdojë.
2. Shpenzimet gjyqësore mbeten siç janë bërë.
3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 15 (*pesëmbëdhjetë*) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Tiranë, më datë **10.09.2024**

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar